

**Njoftim për përqendrim me të cilin Viva Fresh SH.P.K. nga Kosova do të fitojë kontrollin mbi**

**Shoqërinë tregtare KIT-GO SHPKNJP Shtip, Republika e Maqedonisë së Veriut**

**(lënda nr 08-29 të datës 26.11.2021)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës Maqedoni" Nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më datë 26.11.2021, Komisionit për mbrojtjen e konkurrencës i është dorëzuar njoftimi për përqendrim me të cilin Viva Fresh SH.P.K. nga Kosova me seli në Magjistralen Prishtinë Lipjan NN, Suhodol, Graçanicë, Kosovë do të fitojë kontrollin mbi Shoqërinë Tregtare KIT-GO SHPKNJP Shtip, Republika Maqedonisë së Veriut me seli në Bul. Goce Dellçev 52 Shtip, Republika Maqedonisë së Veriut, përmes shitblerjes së pjesëve.

- **Viva Fresh SH.P.K. nga Kosova** është Shoqëri e cila merret me shitje me pakicë të mallrave në shitore-supermarkete jo të specializuara.

Parashtruesi ka një shoqëri të ndërlidhur në treg në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si më poshtë:

- **Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime VIVA FRESH STORE SHPKNJP Shkup**, me seli të regjistruar në Brigada Maqedonase-Kosovare 11 nr.1/1 Shkup-Butel, me aktivitet prioritar - tregti me pakicë në shitore jo të specializuara, kryesisht ushqime, pije dhe duhan.
- **Shoqëria për tregti KIT-GO SHPKNJP Shtip, Republika e Maqedonisë së Veriut** është shoqëri me objekt aktiviteti - tregti të tjera me pakicë në shitore jo të specializuara.  
KIT-GO SHPKNJP Shtip, Republika e Maqedonisë së Veriut ka shoqëri të lidhura në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si në vijim:
- Shoqëria për tregti, hotelieri dhe shërbime TALFA SHPKNJP SHTIP me seli në bul.Goce Dellçev 52, Shtip-Republika e Maqedonisë së Veriut, me aktivitet prioritar- dhënia dhe menaxhimi me pasuri të paluajtshme të veta ose pasuri të paluajtshme të dhëna me qira(lizing).
- **Shoqëria për tregti dhe shërbime TDELTA-ING 2017 SHPKNJP Shtip** me seli të regjistruar në bul..Goce Dellçev 52, Shtip-Republika e Maqedonisë së Veriut, me aktivitet prioritar- dhënia dhe menaxhimi me pasuri të paluajtshme të veta ose pasuri të paluajtshme të dhëna me qira(lizing).

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

17.02.2022

Shkup